



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:053095

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05581024

KPPP.nr.304/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Erwin D.O.O, me seli në Serbi, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Idriz Daci avokat nga Gjakova, ndaj debitorit Exim Jatex, me NUI: 810144395, me seli në rr. Nëna Terezë p.nr, në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Egzon Doli avokat nga Gjakova, duke vendosur lidhur me ankesën për parregullsi të debitorit të datës 18.10.2023 të ushtruar kundër veprimeve përmbartimore të përmbartuesit privat Kushtrim Metaj, në çështjen përmbartimore të evidentuar sipas numrit P.nr.249/23 të datës 11.09.2023, me datën 12.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar Ankesa për parregullsi e Debitorit Exim Jatex, e datës 18.10.2023, me të cilën ka kërkuar që të Anulohet Urdhri P.nr.249/2023 i lëshuar nga Përmbartuesi privat Kushtrim Metaj si dhe të ndërpritet çështja përmbartimore dhe të udhëzohet kreditori për realizimin e kërkesës së tij në procedurë civile.

A r s y e t i m

Debitori Exim Jatex, përmes ankesës së datës 18.10.2023, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë lidhur me parregullsitë e përmbartuesit privat Kushtrim Metaj, gjatë kryerjes së veprimeve përmbartimore në lëndën me numër P.nr.249/23 të datës 11.09.2023, duke kërkuar nga Gjykata që të aprovohet si e bazuar ankesa e Debitorit, të konstatohet se procedura përmbartimore me numër të lëndës P.nr.249/2023 është shoqëruar me parregullsi, të anulohet urdhri përmbartimor dhe të ndërpritet çështja përmbartimore, përkatësisht të udhëzohet kreditori për realizimin e kërkesës së tij në procedurë civile pranë gjykatës kompetente.

Në ankesën për parregullsi debitorit ka theksuar se urdhri përbarimor bazohet në faturën nr. 99/2023 të datës 19.01.2023, faturën nr. 2451 të datës 01.08.2022 të cilat nuk përbëjnë dokument të besueshëm dhe rrjedhimisht kreditori për realizimin e kërkesës së tij është dashur që të inicioj procedurë gjyqësore me anë të padisë civile, duke shtuar që në rast të vërtetimit të pretendimit të tillë, të vërtetohen edhe arsyet e mos nënshkrimit të faturave të lartcekura.

Në fund ka deklaruar se në të gjitha faturat e bashkëngjitura në propozim për përbarim kreditori i referohet marrësit të faturës si “Eximtex” SH.P.K., i cili nuk është subjekti përkatës në rastin konkret, sepse emërtimi i vetëm i debitorit është Exim Jatex. I ka propozuar Gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e debitorit.

Gjykata pas pranimit të ankesës për parregullsi nga ana e debitorit dhe për të vepruar tutje në këtë procedurë, sipas njoftimit të datës 25.03.2024, e ka njoftuar përbaruesin privat Kushtrim Metaj, për të drejtën e paraqitjes së deklaratës në formë të shkruar, lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në ankesën për parregullsi.

Përbaruesi privat Kushtrim Metaj lidhur me parashtresën e debitorit rreth parregullsive të përbaruesit privat gjatë kryerjes së veprimeve përbarimore në lëndën P.nr.249/23, në deklaratën me shkrim të datës 29.03.2024 ka theksuar se veprimet e tij lidhur me këtë çështje përbarimore bazohen në dokumentin e besueshëm, përkatësisht në faturat e lartcekura të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për caktimin e përbarimit. Ka deklaruar se nga shkresat e lëndës evidentohet se debitori me datë 15.09.2023 ka pranuar urdhrin për caktimin e përbarimit dhe duke qenë se nuk ka ushtruar mjetin juridik prapësimin, urdhri për përbarim është bërë i formës së prerë me datë 25.09.2023, ndërsa ekzekutimi i mjeteve monetare të debitorit është bërë me datë 12.10.2023. Ka shtuar që debitori ka dërguar në zyrën e përbaruesit ankesën me datë 18.10.2023, jashtë afatit ligjor.

Në lidhje me pretendimet e debitorit se në të gjitha faturat kreditori i referohet marrësit të faturës si “Eximtex” SH.P.K., e cila nuk është subjekt përkatës në rastin konkret pasi që emërtimi legal i debitorit është Exim Jatex, ka theksuar që e njëjta nuk qëndron për faktin se në faturë ekziston numri unik identifikues 810144395 e po ashtu emri tregtar i Exim Jatex është Eximtex.

Në bazë të thënieve të lartcekura përbaruesi privat ka deklaruar se në procedurën e zhvilluar nga vetë ai nuk ka asnjë parregullsi procedurale dhe si e tillë ankesa e debitorit është e pabazuar, për më tepër debitori nuk e ka respektuar afatin ligjor për prapësim, andaj pretendimet e saj nuk mund të shërbejnë si bazë në ankesën për parregullsi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në ankesën për parregullsi të datës 18.10.2023, deklaramit të përmbauesit privat dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 79 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore, (tutje LPP), gjeti se ankesa për parregullsi e debitorit është në tërësi e pabazuar andaj të njëjtën e refuzoi dhe vendosi si në dispozitivi të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës gjeti se organi përmbaues/përmbauesi privat nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim përmbaimor në mënyrë të parregullt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret, debitori Urdhrin Përmbaimor P.nr.249/23 të datës 11.09.2023 e ka pranuar me datën 15.09.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 16.09.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 22.09.2023. Meqenëse brenda afatit ligjor rezulton se debitori nuk ka paraqitur prapësim, me datën 25.09.2023 urdhri për përmbaim është bërë i formës së prerë, ndërsa përmbauesi privat ka vazhduar me urdhrin për bllokimin e llogarive bankare të debitorit duke u bazuar në nenin 152 dhe 155 të LPP-së, me anë të së cilës janë transferuar mjetet e përmbaimit sipas urdhrit të lartcekur, ndërsa me datën 12.10.2023 është nxjerrë urdhri për lirim-in-de bllokimin e llogarive.

Sipas dispozitës së nenit 79. par. 1 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore përcaktohet se *“Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrojë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbaues gjatë kryerjes së procedurës së përmbaimit. Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës me një parashtrësë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar.”*

Në rastin konkret gjykata vlerëson se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës debitori nuk ka arritur t'i dëshmoj gjykatës se organi përmbaues - përmbauesi privat gjatë zbatimit të procedurës të përmbaimit ka kryer parregullsi, meqenëse i njëjti ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së, duke i ndërmarr të gjitha veprimet procedurale në mënyrë të rregullt.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në ankesën për parregullsi, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të shqyrtohen në këtë fazë të procedurës, meqenëse debitori ka pasur mundësi që këto pretendime ti paraqiste përmes prapësimit si mjet të rregullt juridik të përcaktuar me LPP.

Meqenëse gjykata, nuk ka gjetur se ndonjë veprim përmbarimor është kryer në mënyrë të parregullt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga ana e përmbaruesit privat, e të cilat do të ia cenonin dinjitetin e debitorit, gjykata vlerëson se përmbaruesi privat me veprimet e ndërmarra nuk ka kryer asnjë parregullsi dhe se i njëjti ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 79 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.304/24, datë 12.04.2024

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.